



UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
THIRRJE PËR BOTIM ARTIKUJSH
"BULETINI SHKENCOR"
SERIA E SHKENCAVE SHOQËRORE
DHE SERIA E SHKENCAVE NATYRORE

Ju njoftojmë se janë hapur aplikimet për botim të artikujve shkencorë në “Buletini Shkencor”, Seria e Shkencave Shoqërore dhe Seria e shkencave Natyrore, ISSN:2078-7111, botim i Universitetit “Fan S. Noli”. Mirëpriten punime shkencore të kërkuesve shkencorë, të personelit akademik, studentëve, si dhe punime origjinale të studiuesve nga institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit. Artikujt duhet të jenë rezultat i studimit, veprimtarisë profesionale apo kërkimore-shkencore të vetë autorit/autorëve dhe të mos jenë botuar më parë në ndonjë periodik apo publikim tjetër.

Afati i dorëzimit: 28 prill 2023

Kritere:

- Artikujt dorëzohen në gjuhën shqipe ose anglisht, në format të printuar dhe elektronik. Titulli i punimit, abstrakti dhe fjalët kyçe duhet të jenë në 2 gjuhë: shqip dhe anglisht. Kopja elektronike duhet të jetë në format .pdf dhe në format .doc ose .docx.
- Dorëzimi bëhet pranë Sekretarisë së Këshillit Botues, Biblioteka Shkencore, Godina e Rektoratit/ email: buletini@unkorce.edu.al
- Artikulli dorëzohet i redaktuar dhe i shkruar sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e Buletinit Shkencor Rregullore e buletinit shkencor – University "Fan S. Noli" (unkorce.edu.al)
- Artikulli mund të dorëzohet edhe në formën e një rasti studimor ("case study"), kur trajton në formë të hollësishme një problem me rëndësi kombëtare në konceptin shkencor.
- Artikulli i plotë, duhet të përfshijë në një total prej 10 faqesh tekstin, materialin grafik dhe tabelat së bashku me digjiturat përkatese, si dhe listën e referencave.
- Artikulli dorëzohet së bashku me Deklaratën e Autorit (<http://www.unkorce.edu.al/9338-2/>).
- Artikulli kalon në proces të dyfishtë vlerësimi shkencor. Ekspertët kryejnë vlerësimin e artikullit sipas Formularit të Ekspertit recensues (<http://www.unkorce.edu.al/9334-2/>).
- Në rastet kur artikulli pranohet me ndryshime minimale, ose me ndryshime të rëndësishme, komentet e Ekspertit Vlerësues i përcillen autorit. Ky i fundit, realizon reflektimet e nevojshme në artikull dhe pasqyron çdo ndryshim të mëtejshëm të artikullit në Formularin e Post-recensës (<http://www.unkorce.edu.al/16694-2/>).

Standardet e dorëshkrimit:

- Teksti i dorëshkrimit paraqitet në madhësinë e faqes A4 (përmasa 21 x 29.7cm), hapësira mes rreshtave "Line spacing" = single, , çka nënkupton një sasi të përafërt prej 800 fjalësh për faqe.
- Përmasat e shkruarit "font size", janë 12pt (Times New Roman) dhe hapësira në anët e fletës "margins" do të jetë 3cm në anën e majtë (Left margin) dhe 2,5 cm në tri anët e tjera (lart-top; djathtas-right; poshtë-bottom).
- Artikulli ndërtohet duke respektuar skemën e mëposhtme:
 - a) Titulli (bold 12 pt.): Sa më i shkurtër dhe përmbledhës të jetë e mundur.
 - b) Autorësia (italic 10 pt): Emër/Mbiemër shoqëruar me indekse sipër mbiemrit (I), (2) etj., të cilat shoqërohen me referimin e plotë të emërimit dhe adresës së institucionit nga vjen autori që i përkon indeksi. Indekset me adresat renditen menjëherë poshtë autorëve, secila në një rresht duke nisur nga adresa e autorit të parë, e cila shoqërohet dhe me një kontakt e-mail
 - c) Abstrakti (Italic 12 pt): në 250 fjalë (përafërsisht 15 rreshta) duhet të bëhet një përmbledhje e shkurtër e qëllimit të punimit, përfundimeve dhe rezultateve kryesore. Abstrakti nuk duhet të përmbajë referenca dhe shkurtime.
 - d) Fjalët Kyçe: (italic 10 pt): një sasi prej maksimumi 6 fjalësh kyç.
 - e) Teksti kryesor (Times New Roman 12 pt).
 - Ndërtohet i ndarë në seksione sipas radhës: HYRJA, QËLLIMI, METODOLOGJIA E PËRDORUR, REZULTATET, DISKUTIMI I REZULTATEVE dhe PËRFUNDIME. Titujt e seksioneve janë Bold, UPPERCASE (krejt me shkronja kapitale) dhe mund të ndahen deri në dy nënseksione, titujt e të cilëve dallohen në formatim në këtë mënyrë:
 - Seksion: niveli i parë 1 -TITULLI I SEKSIONIT (bold);
 - Nënseksioni i nivelit të parë 2: Titulli i Nënseksionit 1 (bold, shkronja e parë e çdo fjale kapitale, të tjerat të vogla);
 - Nënseksioni i nivelit të dytë: Titulli i Nënseksionit 2 (italic, shkronja e parë e çdo fjale kapitale, të tjerat të vogla).
 - f) Përdorimi i shkurtimeve: në artikull mund të përdoren shkurtime, kuptimi i të cilave duhet të jetë sqaruar në përdorimin e parë.
 - g) Njësitë: në Buletin njësitë e përdorura do t'i përputhen Sistemit Ndërkombëtar të Njësive.
 - h) Dixhaturat e figurave: duhen paraqitur nën çdo figurë bashkë me referimet përkatëse.
 - i) Referencat: duhen paraqitur në tekst. Në tekst referenca paraqitet (Mbiemri E. viti) ku E. nënkupton inicialin e emrit: Për referencë me dy autorë (Mbiemri 1 El. Mbiemri 2 E2. Viti) për referencë me më shumë se dy autorë (Mbiemri 1 E 1., etj. al. viti).

- Referencat, në listën e referencave, renditen sipas rendit alfabetik, ku i pari në radhë është artikulli më i vjetër nga pikëpamja kronologjike. Nëse një autor apo një grup i njëjtë autorësh kanë botuar në të njëjtin vit, dy apo më shumë artikuj që referohen në artikull, atëhere ata dallohen nga indekset A, B ... etj. (alfabeti latin, jo ai shqiptar), të cilat vendosen përpara vitit dhe citohen në tekst. P.sh. (Mbiemri E. 1999A), (Mbiemri E. 1999B), e po kështu me rastet për dy apo më shumë se dy autorë.
- Nëse në një paragraf citohen më shumë se një referencë ato futen të gjitha në një kllapë rrumbullake dhe ndahen me pikëpresje (;). P.sh (Mbiemri E. Viti; Mbiemri 1 El., Mbiemri2 E2. Viti).
- Në listën e referencave duhet dalluar nëse referenca i përket një libri të plotë, një kapitulli të veçantë nga një libër, një teze ose mikroteze PhD., një raport apo një artikulli në një periodik shkencor.
- Në referencë duhet paraqitur saktë titulli, viti, vendi i botimit dhe viti i botimit, kodet ISSN për revistat shkencore dhe ISBN për librat, si dhe sasia apo totali i faqeve të materialit të referuar.

Rradhitja e të dhënave të një reference në listën e referencave është:

- Emri 1, Mbiemri 1; Emri 2, Mbiemri 2; , , Emrin, Mbiemrin; (viti i botimit).
Titulli. Lloji i materialit të cituar. Titulli i botimit nëse është revistë. Të dhënat e botimit. Vendi i botimit, numri i faqeve, kodi ISSN apo ISBN.

Tarifa e pagesës për autorët që nuk janë pjesë e Universitetit “Fan S. Noli” dhe që janë të interesuar të botojnë në Buletinin Shkencor është 5000 lekë (të rinj) për artikull.

Për më tepër informacion mund t’i drejtoheni Sekretares së Këshillit Botues, znj. Eftiona Bylykbashi, godina e Rektoratit, në mjediset e Bibliotekës Shkencore, ose të dërgoni e-mail në adresën buletini@unkorce.edu.al

Ju falënderojmë!



CALL FOR ARTICLE PUBLICATIONS
"SCIENTIFIC BULLETIN" SOCIAL SCIENCES SERIES
AND APPLIED SCIENCES SERIES
“FAN S. NOLI” UNIVERSITY

We would like to inform you that application for scientific articles publication in the "Scientific Bulletin", Social Sciences Series and Applied Sciences Series, ISSN: 2078-7111, published by "Fan S. Noli" University are open. Scientific research papers of researchers, academic staff, students, as well as original works of researchers from other local and foreign institutions are welcomed. Articles must be the result of the study, professional or research activity of the author/authors themselves and must not have been previously published in any periodical or other publication.

Submission deadline: April 28, 2023

Criteria:

- Articles should be submitted in Albanian or English language, in printed and electronic formats. The title, abstract and key words should be submitted in Albanian and English language. The electronic copy should be in .pdf and in .doc or .docx. format.
- Articles should be submitted to the Secretary of the Publishing Council, Scientific Library premises, Rectorate Building/ Email: buletini@unkorce.edu.al.
- The article should be submitted edited and written according to the criteria defined in the Scientific Bulletin Regulation Rregullore e buletinit shkencor – University "Fan S. Noli" (unkorce.edu.al)
- The article can also be submitted in the form of a case study in case it treats in detail a problem of national importance in the scientific concept.
- The full article should include in a total of 10 pages the text, the graphic material and tables together with the relevant table/figures captions as well as the reference list.
- The article should be submitted together with the Author's Declaration (<http://www.unkorce.edu.al/9338-2/>).
- The article passes through a double process of scientific evaluation. Experts evaluate the article according to the Expert Reviewer Form (<http://www.unkorce.edu.al/9334-2/>).
- In cases where the article is accepted with minimal changes, or with significant changes, the comments of the Appraisal Expert are forwarded to the author. The latter performs the necessary reflections on the article and reflects any further changes to the article in the Post-Review form (<http://www.unkorce.edu.al/16694-2/>).

Standards for the written paper:

- The written paper text is presented in A4 paper size (size 21x29.7cm), "Line spacing" = single, which means an approximate amount of 800 words per page.
- The font size should be 12pt (Times New Roman) and the "margins" should be 3cm on the left side (Left margin) and 2.5 cm on the other three sides (top; right; bottom).
- The article is constructed according to the following scheme:
 - a. Title (bold 12 pt.): As brief and concise as possible.
 - b. Authorship (italic 10 pt): Name/Surname accompanied by indexes above the surname (I), (2) etc., which are accompanied by the full reference of the name and address of the institution where the author to whom the index belongs comes from. The indexes with the addresses are listed below the authors, each of them in one row starting from the address of the first author, which is accompanied by an e-mail address.
 - c. Abstract (Italic 12 pt): in 250 words (approximately 15 lines) should include a brief summary of the paper aim and objectives, conclusions and main results.
The abstract should not contain references and abbreviations.
 - d. Keywords: (italic 10 pt): a maximum of 6 keywords.
 - e. Main text (Times New Roman 12 pt).
 - It is constructed divided into sections in the following order: INTRODUCTION, AIM, METHODOLOGY, RESULTS, DISCUSSION ON RESULTS and CONCLUSIONS.
The titles of the sections should be written in Bold, UPPERCASE (all in capital letters) and can be divided into up to two subsections, the titles of which should be presented in the following format:
 - Subsection of the first level : Title of Subsection 1 (bold, first letter of each word in Capitals, other letters in lowercase);
 - Subsection of the second level: Title of Subsection 2 (italic, first letter of each word in Capitals, other letter in lowercase);
 - f. Use of abbreviations: it can be used abbreviations in the article, the meaning of which must be explained in their first use.
 - g. Units: in the Bulletin the units used will comply with the International System of Units.
 - h. Figure captions: should be presented under each figure together with the relevant references.
 - i. References: should be presented in the text. In the text the reference is presented (Surname E. year) - E. refers to the initial of the name: For reference with two authors (Surname 1 E1. Surname 2 E2. Year) for reference with more than two authors (Surname 1 E 1., etc. . al. year).

- In the list of references the references are listed in alphabetical order, with the first reference in the list being the oldest reference in chronological order. If an author or a group of authors have published in the same year two or more articles referred to in the article, then there are used the indexes A, B ... etc. (Latin alphabet, not Albanian alphabet), which are placed before the year and quoted in the text. For example, (Surname E. 1999A), (Surname E. 1999B). Same way in cases of two or more authors.
- If more than one reference is cited in a single paragraph they are all written in parentheses and separated by semicolons (;). For example (Surname E. Year; Surname 1 El,. Surname2 E2. Year).
- In the list of references it should be specified whether the reference belongs to a complete book, a separate chapter from a book, a PhD thesis or micro-thesis, a report or an article in a scientific periodical.
- In the reference must be clearly specified the exact title, year, place and year of publication, ISSN codes for scientific journals and ISBN for books, as well as the quantity or the total number of pages of the material that is used for reference.

The order of the reference data in the reference list should be as follows:

- Name 1, Surname 1; Name 2, Surname 2;,, Name, Surname; (publication year). Title. Type of material cited. Title of publication if it is taken from a Journal. Publication details. Place of publication, number of pages, ISSN or ISBN code.

For authors who are not part of "Fan S. Noli" University and who are interested in publishing in the Bulletin the fee is 5000 ALL (new) per article.

For more information you can contact the Secretary of the Publishing Council, Ms. Eftiona Bylykbashi, Rectorate building, in the premises of the Scientific Library, or send an e-mail to the e-mail address: buletini@unkorce.edu.al

Thank you!